

# Ekonomika e Softverit – Kaptulli I

## **KUPTIMI I INVESTIMEVE**

# Ç'farë përfshin nocioni i investimeve?

- Nocioni i investimeve përfshin një spektër të gjerë të aktiviteteve të njeriut.
- Investimi ose të investuarit është një term me disa kuptime të ngjashme të lidhura ngushtë ndërmjet veti në menaxhim të biznesit, financa, ekonomi dhe informatike, lidhur me kursimin ose konsumimin e më vonshëm.

- Fjala “investim” rrjedh nga fjala latine “vestis” që do të thotë “rezervë, sasi malli ose veshje” dhe i referohet aktit të vënies së gjërave (paratë ose gjësendet e tjera në resurse) në xhepat e dikujt tjetër.
- Pra, investimi nënkupton angazhimin e një shume të dhënë parash në kohën e tashme, në pritje të kthimit të një shume më të madhe në të ardhmen.

- Ne kuptim te gjere me investim kuptojme angazhimin e mjeteve financiare (parave) ne: **patundshmeri, letra me vlere** (aksione, bonde, etj), **studime dhe kerkime shkencore, arsimimin e personelit**, etj, dhe qellimi i te gjitha ketyre investimeve eshte maksimizimi i fitimit.
- Pra dallojme investimin ne **asete reale dhe asete financiare**. Asetet reale ndikojne ne rritjen e menjehershme te kapacitetit prodhues, perkatesisht kapaciteteve per te krijuar nje produkt apo sherbim dhe per ta shitur ate ne treg. Nderkaq asetet financiare kontribuojne ne menyre te terthortë dhe derivojne nga asetet reale te firmes.

- Investimet në kuptimin e plotë të fjalës janë parakushti themelor i arritjes së qëllimeve zhvillimore. Ato mund të përkufizohen si një angazhim i mjeteve financiare, apo i të mirave të tjera materiale të shprehura financiarisht, në realizimin e qëllimeve zhvillimore.
- Botëkuptimi bashkëkohor i qeverisjes së investimeve ka tejkaluar pikëpamjet sipas të cilave me investime kuptohet vetëm instalimi i pajisjeve të reja, ndërtimi i godinave apo infrastrukturës.

- **Qellimi i investimit** eshte sigurimi i ekzistences ne rrethinen e pasigurte, ngritja e nivelit te efikasitetit dhe mireqenies ne kohen e tashme poashtu edhe ne te ardhmen, etj.
- **Nevojat per investime** rrjedhin nga rrethina nepermjet konkurences dhe kjo dikton nevojen per permirsimin e teknologjise, aftesine e personelit, rritjen e games se produkteve, pushtimin e tregut ne vend dhe jasht vendit, etj.

- **Investimet mund të perkufizohen si** *angazhim i mjeteve financiare, apo i të mirave tjera materiale të shprehura financiarisht, për realizimin e qëllimeve zhvillimore si dhe paraqesin një akt të vetedijshëm të heqjes dore nga konsumi i tanishëm në emër të shpresës për efekte më të mëdha serike në të ardhmen*
- (rreziku dhe fitimi janë të pandashme dhe janë në perpjestim të drejtë mirpo investitori racional e minimizon rrezikun dhe kërkon kthim adekuat).
- Gjate investimeve duhet të mirren parasysh efektet serike që priten në të ardhmen nga investimi si dhe **pasiguria dhe rreziku** që e percjellin investimin.

- Lidhur me investimet **MASSE** thot “investimi paraqet kembimin e nje te mire te sigurt nga konsumi i te ciles hiqet dore, me shpresen qe kemi ne objektin e investuar” ndersa
- **SHARPE** thote “investimi eshte sakrifikimi i nje vlere te tanishme per nje vlere te ardhme te mundshme me te madhe”, gjithshu ai ben dallimin midis kursimit dhe investimit.
- Derisa kursimi paraqet **heqje dore nga konsumi, investimi behet per ta arritur outputin ne te ardhmen.** Mbajtja e parase te paangazhuar apo shpenzimi i saj ne konsum dmth heqje dore nga fitimi mbi investimin.
- Dëshira e investitorit eshte fitimi sa me i madh, mirepo investimi ballafaqohet me rrezikun.



# Sistemi i investimeve

- Sistemi i investimeve paraqet bashkesine e aktiviteve te nderlidhura ne rrafshe te ndryshme te sistemit ekonomik, nepermjet te cilave mjetet financiare angazhohen dhe transformohen ne rezultate qe shprehen me rritjen e outputeve.
- Elementet e sistemit te investimeve jane:
  - a) Politika investive
  - b) Analiza parainvesticionale dhe Plani i investimeve
  - c) Vendimi investiv
  - d) Financimi
  - e) Realizimi

# Politika investive

- Paraqet *zberthimin me konkret(ne detale) te politikës zhvillimore* e cila ka nje karakter me te gjithanshem , me afatgjate dhe ne baze te kesaj politike vime deri te plani i investimeve.
- **Ne nivel te ekonomise se vendit** politika investive ndertohet se bashku me politikat tjera makroekonomike (politika monetare e kreditore, politika monetare, politika buxhetore, politika doganore, etj) dhe nepermjet saj ndikohet ne vellimin dhe strukturen e investimeve ne sektore dhe rajone te caktuara.
- **Ne nivel te ndermarrjes** politika investive percaktohet varesisht nga politika e tyre zhvillimore.

# Analiza parainvesticionale dhe Plani i investimeve

- Perfshin te gjitha aktivitetet qe kane te bejne *me identifikimin e projekteve duke u bazuar ne politiken investive dhe ne sistemin informatik.*
- Ne kete rast behen analizat e ndryshme sektoriale, nxjerren ide te ndryshme mbi investimet e mundshme prej nga identifikohen projektet, alternativat e tyre, vlersimi i ketyre alternativave dhe perzgjedhja e tyre.
- Ne baze te kesaj formohet plani i investimeve.

# Vendimi investiv

- Ka të bëjë me vendimin final lidhur me pranimin apo refuzimin e projektit të caktuar investiv.
- Ky vendim mirret në bazë të studimit të fizibilitetit dhe atë e merr investitori.

# Financimi

- Ka te bej me sigurimin e mjeteve financiare te cilat jane percaktuar ne studimin investiv dhe te cilat jane te nevojshme per realizimin e projektit.
- Per kete gje perkujdeset investitori i cili qeveris me mjetet e tij te lira per investime, hyn ne kredi, ose posedon aksione dhe letra te tjera me vlere, siguron bashk investitorë, etj.

# Realizimi

- Paraqet bashkesine e aktiviteteve te cilat e ndertojne projektin investiv.
- Ketu hyn dokumentacioni teknik, ndertimet, montimet, instalimet dhe aktivitetet e tjera te cilat e perfundojne procesin e transformimit te mjeteve financiare ne objektin investiv nga i cili priten efekte ne periudhen e eksploatimit.

- **1) Inputet (X)** e sistemit te investimeve jane: *politika e zhvillimit* (perfshin qellimet e shtetit per zhvillimin ekonomik, politiken e tij makroekonomike dhe politiken e afarizmit te ndermarrjes),
- **Resurset** (kane te bejne me inputet lidhur me burimet humane, natyrore, financiare, energjetike, etj te cilat gjate realizimit te projektit investiv formojne objektin investiv), dhe informatat (kane te bejne me njohurite mbi tregun, teknologjite e reja, kerkimet shkencore, ecurite e ekonomise vendore, si dhe informatat rreth realizimit te projektit investiv).

- **Outputet (Y)** janë objektet investive që *hyjne në punë në ciklin e eksploatimit dhe ndikojnë në rritjen e fitimit të investitorit.*
- Outputet paraqiten si fonde prodhuese dhe shërbyese të investitorit apo si potenciale intelektuale të tij.



- *Rrethina e sistemit te investimeve* perbehet nga **sistemi natyror, sistemi shoqerore dhe sistemi ekonomik.**
- E gjithë kjo rrethine (me shume sistemi ekonomik) ka ndikim si ne inputet ashtu edhe ne outputet e sistemit te investimeve.
- Sistemi ekonomik dhe ai shoqerore krijojne rrethinen institucionale duke bere ndikim te madh ne inputet dhe kushtet e tjera te realizimit te projekteve investive.

# Funksionimi i sistemit te investimeve

- Funksionimi i sistemit te investimeve eshte **si rezultat i interaksionit midis elementeve te tij** (politika e investimeve, plani i investimeve, vendimi investiv, financimi dhe realizimi).
- Ne saje te ketij interaksioni zhvillohet sistemi i investimeve respektivisht procesi i shendrrimit te inputeve ne outpute dhe **ky transformin ne te vertete paraqet vet procesin investiv (cikli i nje projekti).**

- *Procesi investiv paraqet nje kompleks aktivitetesh* interaktive te cilat kane te bejne me: identifikimin e projektit, pergaditjen e projektit, vleresimin, realizimin e projektit si dhe percjelljen dhe vlersimin e efekteve te tij (periudha e eksploatimit) –ex post.

Ne procesin investiv mund te dallojme tri faza kryesore:

- Fazen e pergaditjes se projektit investiv
- Fazen e realizimit te projektit investiv
- Faza e eksploatimit (analiza ex-post)

# Faza e pergaditjes se projektit investiv

- Ka te bej me fazen e grumbullimit te ideve per investime, seleksionimin e ketyre ideve, identifikimin e projekteve investive, analizen, vleresimin dhe perzgjedhjen e alternativave te ndryshme dhe perfundon me **marrjen e vendimit investiv**.

# Faza e realizimit te projektit investiv

- Fillon menjehere pas marrjes se vendimit pozitiv lidhur me projektin dhe ka te bej me sigurimin e burimeve financiare per financimin e projektit, pergaditjen e dokumentacionit detal per zbatimin e projektit, ndertimet, instalimet dhe montimet dhe ne te njejten kohe behet pergaditja per treg, pergaditja per prodhim, per zbatimin e struktures organizative, etj.

# Faza e eksploatimit

- Per procesin investiv kjo periudhe eshte e rendesishme sepse ne kete faze testohen parametrat e projektit.
- Kjo sherben per te bere ndonje permirsim eventual si dhe per te nxjerre pervoje per persosjen e menaxhmentit te projekteve investive.

- **Faza e pergaditjes** se projekteve merr pjese ne fiancimin e projektit **5-10%** kurse ne efektet negative merr pjes rreth **60%**, nderkaq **faza e realizimit** merr pjese ne financim **90-95%** ndersa ne efekte negative rreth **40%**.
- Andaj ne baze te kesaj e shohim rendesine e fazes pergaditore te ciles duhet ti kushtojme rendesi te madhe dhe nuk preferohet te ngutemi dhe ti kursejme mjetet ne kete faze. E tere kjo me qellim te menjanimt te efekteve negative e cila mund te jete si pasoje e mosqeverisjes cilsore te fazes pergaditore te projektit investiv.

# Vendimet investive dhe llojet e tyre

- Menaxhimi i projekteve investive behet nepermjet marrjes dhe realizimit te vendimeve, dhe keto vendime jane te shumta sepse ndermirren gjate fazate te ndryshme gjate zhvillimit te procesit investiv.

Per kete arsye vendimet investive karakterizohen keshtu:

- **Vendimet makroinvestive (VMaI)**
- **Vellimi i investimeve**
- **Efikasiteti (sukseshmeria) i investimeve**



- Shteti për të ndermarre një politike investive mbështetet edhe në **analizat sektoriale** dhe në bazë të këtyre analizave përcaktohet strategjia afatgjatë e zhvillimit të sektoreve dhe prioritetëve zhvillimore në vend.
- **Analizat sektoriale kanë të bëjnë me prioritetet zhvillimore në kuadër të** bujqësisë, industrisë, energjisë, shëndësisë, edukimit, etj dhe në bazë të këtyre analizave përcaktohet politika e investimeve e cila mbështetet me anë të instrumenteve të politikës makroekonomike

- **Ndikimi i drejteperdrejte** i shtetit ne politiken investive behet nepermjet investimeve publike sepse investimet publike kane te bejne me zhvillimin e infrastruktures kryesore si asaj te: **telekomunikimeve, energjetikes, edukimit, shendetesise, etj.**
- **Nderkaq ndikimi i terthorte** i shtetit ne politiken e investimeve eshte nepermjet politikës se taksave, normave te kamates, politikës se taksave, kurseve te kembimit, etj

# Vendimet paraprake investive (VPrI)

- Keto vendime kane te bejne me perzgjedhjen paraprake te ideve per investime, vlersimin e tyre dhe formulimin e planit te investimeve.
- Keto vendime i marrin menaxheret kryesore ne bashkpunim me analistet sistemor.
- Ne bazet te ketyre vendimeve krijohet plani i investimeve i cili perfshin alternativat qe jane aprovuar si dhe alternativat rezerve.
- Plani i investimeve behet ne nivel te ndermarrjes si dhe ne nivel te shtetit per investime publike.

# Vendimet mikroinvestive (Vmi)

- Ky vendim ka te bej me pranimin **apo refuzimin e projektit** te caktuar investiv, dhe kete vendim e bie menaxheri kryesor i projektit.
- Ky vendim sillet ne baze te studimit investiv. Vendimet **mikroinvestive behen ne baze te prioriteteve zhvillimore** dhe ne baze te faktit se sa treguesit financiare dhe ekonomik te projektit investiv jane ne perputhshmeri me qellimet e percaktuara te projektit.

# Vendimet operative investive (VOI)

- Keto vendime ndermirren nga menaxheri i projektit dhe ekipi i tij *ne fazen e realizimit te projekteve investive.*
- Me ane te vendimeve operative investive **udhehiqet procesi i realizimit te projektit.**
- Keto vendime kane rendesi te madhe *per shfrytezimin sa me racional te burimeve te angazhuara dhe per zhvillimin e te gjitha aktiviteteve ne kohen e parapare*

# Efikasiteti i sistemit te investimeve

- Efikasiteti i funksionimit te sistemit te investimeve **shprehet** nepermjet **efiqences** (shpenzimet per krijimin e nje njesie outputi) dhe **efektivitetit** (raporti midis outputit dhe outputit te planifikuar).
- Mund te thuhet se efikasiteti i sistemit te investimeve eshte i varur **drejteperdrejte nga cilsia e vendimeve investive** (te gjitha vendimeve investive, qe i permendem me pare) dhe kjo krijon kushte per rritjen e sinergjise ne kuader te sistemit te investimeve.

# Efekti sinergjik i sistemit te investimeve

- Pra efekti sinergjik tregon se kur te gjitha elementet e sistemit veprojne si teresi dhe jane ne harmoni me njera tjetren japin efekte me te medha sesa kur veprojne te vecanta.
- Praktika e qeverisjes se investimeve ne Kosove deshmon se kur nuk ekziston nje sinergji ne sistemin e investimeve krijohen defekte dhe bie efikasiteti i investimeve. Sepse per nje periudhe te gjate kemi pasur nje **disharmoni te madhe midis vendimeve Makroinvestive dhe Mikroinvestive** dhe kjo ndikoi ne nje efikasitet te ulet te sistemit te investimeve ne Kosove.

# STUDIMI I FIZIBILITETIT TE PROJEKTEVE

- **Studimi i fizibilitetit te projektit paraqitet si element lidhes** me seleksionimin, monitorimin, dhe planifikimin e projektit.
- **Studimi i Fizibilitetit** behet nga ekipet e eksperteve dhe **paraqet nje analize komplekse sistemore te nje projekti** ku testohen parametrat e tij ekonomik, dhe ne baz te ketij studimi menaxheret aprovojne apo refuzojne projektin e caktuar. Bartes te ketij studimi jane institucione shkencore kerkimore, apo sherbimet zhvillimore te organizatave.
- Ne rast te aprovimit pozitiv hapi tjetër është **faza e planifikimit te projetit** i cili perfshin vlersimin e afarizmit te projektit dhe percaktimit te **strategjise se zhvillimit te projektit** dhe vlersimin e **rrezikut potencial**.



- Realizimi dhe mbikqyrja e projektit bazohen ne planin e projektit. Ne baze te planit te projektit punon ekipi, dhe ky ekip harton raportet e nevojshme per monitorimin e projektit.
- **Raportet** duhet te permbajne informata mbi progresin e realizimit te projektit, pastaj te gjitha kerkesat per qdo ndryshim eventual si arsye e faktorve te brendshem dhe te jashtem etj.